



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A.nr.308/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2014, mori këtë:

### **V E N D I M**

**MIRATOHET** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kështu që Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 1050 (njëmijë e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

### **Arsyetim**

PZAP-i ka pranuar një ankesë më datë 09.06.2014, nga Lëvizja Vetvendosje (LVV) dega në Besianë, me të cilën pretendohet se më datë 07.06.2014, edhe pse heshtje zgjedhore, aktivistët nga radhet e LVV-së rreth ores 16:00, kanë vërejtur se në Rr. “Zahir Pajaziti” në afërsi me pak se 100 metra nga shkolla e mesme ekonomike “Isa Boletini” ishte i vendosur bilbordi i kandidatit Isa Mustafa nga subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

LVV pretendon se me këtë veprim LDK ka bërë shkelje të nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore nr. 11/2013 të KQZ-së dhe Nenit 3 pikës 4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi, në të cilat shihet bilbordi i vendosur afër Qendres së Vendvotimit nga subjekti politik LDK. Parashtruesi i ankesës propozon që ndaj subjektit politik të lartë përmendur të ndërmerren masa ligjore në pajtim me LZP.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it informoi subjektin politik LDK, më datë 10.06.2014, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë deri më datë 11.06.2014, deri në ora 10:00.

PZAP-i, mori përgjigje në ankesë nga subjekti politik LDK, sipas afatit të caktuar, në të cilën theksohet se bilbordi ishte i vendosur që nga fillimi i fushatës zgjedhore jashtë rrethojës së shkollës dhe se nuk është vendosur me kurrfarë qëllimi në ditën e heshtjes zgjedhore. Me tutje në përgjigjen në ankesë theksohet se të tilla bilborde në vendet e dedikuara për reklama dhe marketing jashtë rrethojave të shkollave ekzistojnë edhe sot në tërë Kosovën.

**Veprimet e Ndaluar Para Procesit të Votimit** – përcaktohen bazuar në Nenin 36.1 të LZP-së dhe Nenin 7.1 të Rregullës Zgjedhore 11/2013 në të cilat specifikohet se :

*Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohej secili prej veprimeve si më poshtë:*

a) shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit;

b) bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

### **Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve**

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

*Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:*

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

PZAP-i pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- **ankesa është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se padyshim subjekti politik LDK, ka thyer heshtjen zgjedhore, në mënyrën siç pretendohet në ankesë. Një gjë e tillë shihet nga fotografitë e ofruara nga parashtruesi i ankesës, nga e cila rezulton se bilbordi i kandidatit Isa Mustafa ishte i vendosur me afër se 100 metra afër Qendres së Vendvotimit në Besianë dhe i njëjti nuk është larguar nga largësia prej 100 metra as në ditën e votimit.

Duke marr parasysh se subjekti politik i lart përmendur, në këto zgjedhje për herë të dytë ka bërë thyerje të heshtjes zgjedhore në mënyrën e lartpërmendur, PZAP-i, duke vlerësuar edhe rrethanat tjera të lartpërmendura, të njëjti subjekt i shqipton gjobën lart cekur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prandaj nga arsyet e lartcekura, në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 308/2014 më datën 12.06.2014



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*